



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1412/ 5 prot.

Datë 16 /07/2025

V E N D I M

Nr.915/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16/ 07/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CompiTel” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Ref-40796-03-11-2025, me objekt “Blerje goma” me fond limit 6,306,801 (gjashtë milion e treqind e gjashtë mijë e tetëqind e një) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrimit Publik.

Ankimues:

Operatori ekonomik “CompiTel” shpk me NIPT M31417021V dhe adresë *Bashkia Tirane, Rruga iFrosina Plaku, Njesia Administrative Nr.7, Zona Kadastrale 8220, Pallati S.*

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrimit Publik, me adresë *Rruga “5 Maji” , Tiranë*”.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12-03-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Ref-40796-03-11-2025, me objekt “Blerje goma” me fond limit 6,306,801 (gjashtë milion e treqind e gjashtë mijë e tetëqind e një) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrimit Publik.

.

II.2. Në datën 11-04-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

II.3 Në datën 19.05.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “TYRE MASTER ”SHPK	5.641.400	lekë	Skualifikuar
2. “ COMPITEL ” SHPK”	5.873.520	lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 27.05.2025 Autoriteti Kontraktor ka publikuar Anullimin e procedurës SË prokurimit në sistemin të prokurimeve elektronike (S.P.E.).

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5370, datë 02.06.2025 dhe me nr.1412/2025 Prot., dhe protokolluar me datë 02.06.2025 e operatorit ekonomik “Compitel”shpk , duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.6 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1412/1 prot., datë 03.06.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga ankimuesi.

II.7 Më datë 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit publik, në sistemin elektronik, si dhe nëpërmjet shkresës me nr. 1412/2, datë 16.06.2025, me objekt “ *Kthim përgjigje* ”, në lidhje me vlerësimin ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Compitel” shpk, për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton se nuk e ka pranuar ankesën e paraqitur.

II.8. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ,sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Compitel” shpk , mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik me arsyet se:

“1. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 3: Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient pune, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të montimit të gomave, për të cilin duhet të paraqes dokumentacion e mëposhtëm:.....pasi OE ka paraqitur një deklaratë si dhe një akt marrëveshje noteriale, me nr. Rep.1585 dhe nr. Kol. 976, ku shërbimin për kryerjen e montimit të gomave do ta bëjë shoqëria ALPA shpk me seli në Lac. KVO arsyeton si më poshtë: Bazuar në parimin e efikasitetit dhe mirëpërdorimit të fondeve publike, si parashikohet në nenin 2 të Ligjit nr.162/2020 Për prokurimin publik (i ndryshuar), është e arsyeshme që shërbimet e mirëmbajtjes, përfshirë ndërrimin e gomave për automjetet në përdorim nga institucionet e Bashkisë Tiranë, të kryhen brenda qarkut të Bashkisë, për të garantuar: - koordinim të shpejtë dhe efikas të ndërhyrjeve, në rast të defekteve të papritura; - ulje të kostove operative, si transporti i mjeteve jashtë territorit të Bashkisë; - mbikëqyrje më të lehtë dhe monitorim të cilësisë së shërbimit nga vetë institucionet publike përkatëse”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 8, pika 3 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. *Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient pune, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të montimit të gomave, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
 - a) *Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:*
 - *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
 - *Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose*
 - *kontrata e shitblerjes; ose*
 - *kontrata e dhurimit; ose*
 - *çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
 - *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*
 - *Kontratë huaje.*
 - *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
 - *Kontratë qiraje.*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

-Kontratë Qiraje me nr. repertori :1132 dhe nr. koleksioni : 446, datë 04.03.2025, e cila rezulton me palë : Qiradhënës Z.M dhe Qiramarrës shoqëria “Compitel” shpk ;

II.1.3. Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. *Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e*

prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij

II.1.4. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: *“Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient pune, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të montimit të gomave, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- *Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose*
- *kontrata e shitblerjes; ose*
- *kontrata e dhurimit; ose*
- *çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë*
- *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*
- *Kontratë huaje.*
- *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
- *Kontratë qiraje.”.*

III.1.8 Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “COMPITEL” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin SPE si më poshtë: -Kontratë Qiraje me nr. repertori :1132 dhe nr. koleksioni : 446, datë 04.03.2025, e cila rezulton me palë : Qiradhënës Z.M dhe Qiramarrës shoqëria “Compitel” shpk.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit e operatorit ekonomik ankimues për mospërmbushjen e kriterit, si dhe referuar verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Compitel ” SHPK, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Compitel ” SHPK rezulton se ka përmbushur kriterin, i cili ka parashikuar kërkesën si në vijim *“Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient pune, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të montimit të gomave, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- *Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose*
- *kontrata e shitblerjes; ose*

- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë
- Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:
- Kontratë huaje.
- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
- Kontratë qiraje.”.

Përsa kohë nga operatori ekonomik pjemarrës në procedurën e prokurimit “Compitel ” SHPK, rezulton se ka përmbushur detyrimin ligjor, që vjen si rrjedhojë plotësimit të kërkesave të parashikuara në shtojcën nr. 8, pikës 3 nga autoriteti kontraktor, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron. Komisioni i Prokurimi Publik vlerëson se përsa kohë në përmbushje të kriterit të sipërmendur operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin - Kontratë Qiraje me nr. repertori :1132 dhe nr. koleksioni : 446, datë 04.03.2025, e cila rezulton me palë : Qiradhënës Z.M dhe Qiramarrës shoqëria “Compitel” shpk., ankimuesi ka përmbushur kriterin e parashikuar në shtojcën 8, pika 3 pjesë e dokumentave të tenderit.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Compitel” shpk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Compitel” shpk me arsyetimin se:

“• *Operatori Ekonomik nuk përmbush piken 6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për të gjitha gomat, në formë tabele, ku të plotësohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Emërtimi i artikullit (kodi) nxjerrë nga manuali i prodhuesit, linku i produktit në Ëeb-in e prodhuesit si dhe çertifikimet përkatëse për secilin produkt.....Pasi OE ka paraqitur ofertën teknike por nuk është e firmosur dhe vulosur nga administratori i kompanisë”, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se,*

III.2.1 Në shtojcën 8, pika 6 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“6. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për të gjitha gomat, në formë tabele, ku të plotësohet:*

Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Emërtimi i artikullit (kodi) nxjerrë nga manuali i prodhuesit, linku i produktit në Ëeb-in e prodhuesit si dhe çertifikimet përkatëse për secilin produkt.”

III.2.2. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së,

janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

III.2.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; 20 b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”*

III.2.4. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit

162/2020 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të 21 gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.6. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ankimues për sa i përket ... *OE ka paraqitur oferten teknike por nuk është e firmosur dhe vulosur nga administratori i kompanise*”, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në fjalë Compitel shpk referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ky i fundit rezulton se në përmbushje të kriterit të parashikuar në pikën 6 të shtojcës 8 të DST ka ngarkuar në sistem dokumentacionin me të dhëna si në vijim: Ofertë Teknike, data 11.04.2025 , “Compitel” SHPK .

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar kërkesa për paraqitjen e ofertës teknike

Gjithashtu referuar kriterit të parashikuar në DST si dhe arsyes së skualifikimit nga autoriteti kontraktor, si në vijim ... *OE ka paraqitur oferten teknike por nuk është e firmosur dhe vulosur nga administratori i kompanise*, Komisioni vlerëson se arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nuk është e parashikuar si kriter në dokumentat standarte të tenderit, për t’u përmbushur nga operatorët pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

Komisioni vlerëson se përsa kohë operatori ekonomik ka ngarkuar në sistemin elektronik dokumentacionin “Ofertë teknike”, është në kushtet e përmbushjes së kriterit të parashikuar në shtojcën 8 pika 6.

Sa më lart pretendimi i i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Compitel” SHPK, për procedurën eprokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Ref-40796-03-11-2025, me objekt “Blerje goma” me fond limit 6,306,801 (gjashtë milion e treqind e gjashtë mijë e tetëqind e një) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Compitel” SHPK duke e kualifikuar.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Compitel” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

